

Zyrjeta Rrudhani, MA¹

UDK:
368.91(497.115)

**SIGURIMET E JETËS DHE SIGURIMET JO-JETË
(RASTI I KOSOVËS)**

**ОСИГУРУВАЊЕТО НА ЖИВОТОТ И НЕЖИВОТОТ
(СЛУЧАЈОТ НА КОСОВО)**

**LIFE AND NONLIFE INSURANCE AND
(KOSOVO CASE)**

Abstract

The banking system in Kosovo before the war was characterized by a strong central government control in all aspects of the system. Despite the widespread banking system, which was set up focusing mainly on the care of state mechanisms, the banking system in Kosovo of the Communist era in former Yugoslavia was largely governed by government and state mechanisms. The system was highly centralized, where the Ministry of Banking and Finance regulated all banking services in the country and decided to allocate resources and appoint management personnel. Violence and war resulted from a major deterioration of the economy, the financial system, the banking system infrastructure and the cessation of the activity of many banks and subsidiaries in the cities of Kosovo.

A series of sectoral reforms began after 2000, but for these years little progress has been made to advance the banking system and the advancement of banking services. Insurance is a very effective tool

¹ Autorja ka përfunduar studimet e rregullta dhe postdiplomike në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Ekonomik - Banka, financa dhe kontabilitet dhe mori titullin Magjistre e shkencave ekonomike.
Email adresa: zyrjetarrudhani@gmail.com

through which people can control their financial losses, whether they are physical or legal persons. So security today is not something taboo, but they are a need for a safer future. In Kosovo today there is a well-consolidated insurance market, which has sufficient capacity to provide the necessary insurance to protect the citizens of Kosovo and their businesses from different events whether they are natural or other disasters, and which could cause considerable financial damage. And in order not to deal with such situations, in the event of natural disasters or other disasters, where financial losses would be unpredictable, all we have to do is have a more serious approach to the future and the unexpected can bring it to us.

Key words: insurance, financial system, assets.

Hyrje

Aktualisht, në Kosovë ekziston një numër mjaft i mirë i kompanive të sigurimit që operojnë. BQK-ja nuk vë ndonjë kufizim mbi numrin e kompanive të sigurimit që mund të veprojnë në Kosovë. Kriteret e licencimit që përdoren nga BQK-ja kanë të bëjnë me cilësinë e aplikuesve. Nëntë nga kompanitë e sigurimeve që aktualisht veprojnë në Kosovë janë në pronësi të huaj të cilat menaxhojnë rreth 67% të totalit të aseteve të sektorit. Kurse kompanitë e tjera janë në pronësi vendase të cilat menaxhojnë rreth 33% të aseteve të sistemit. Kompanitë e sigurimeve janë ndërmjetësues financiar të cilët për një çmim që përcaktohet nëpërmjet një kontrate sigurimi e që mishërohet në policën e sigurimit, do të bëjnë pagesa zhdëmtimi në rast të aksidenteve dhe dëmtimeve të ndodhura dhe në rast vdekje të palës së siguruar. Thënë më ndryshe, funksioni i tyre është bartja e rrezikut.² Kompanitë e sigurimeve janë ndër instrumentet financiare më të rëndësishme, bile në shtetet e zhvilluara këto institucione edhe janë më të fuqishmet në kuptimin financiar. Praktikant financiare në vendin tonë demonstrojnë një nivel më të ulët të fuqisë financiare të kompanive të sigurimit. Në vendin tonë kemi një zhvillim të ngadalshëm të tregut të sigurimeve, sepse kompanitë e sigurimeve janë të reja, si dhe qasja e klientëve në

² http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2015/FINALI_SISTEMI%20FINANCIAR_Nentor_20_2016

org/repository/docs/2015/FINALI_SISTEMI%20FINANCIAR_Nentor 20 2016

produktet e sigurimeve është pranuar më ngadalë sesa të themi te produktet bankare.³

1. Sigurimet

Sigurimet po ashtu janë edhe një stimulues në kontrollimin e humbjeve të papritura, duke pasur një përfitim të konsiderueshëm social dhe ekonomik. Pra, sigurimet nga sa mund të shihet më lartë dhe jo vetëm, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillim ekonomik duke u mundësuar individëve dhe bizneseve që t'i alokojnë aktivitetet e tyre në produktivitate më të larta, duke e pasur prapa vetes një siguri të cilën e ofrojnë kompanitë e sigurimeve përmes kontratave të sigurimit në rastet kur këta individ apo biznese mund të pësojnë një humbje të papritur.

Sigurimet janë shumë të ndërlydhura me zhvillimin ekonomik të vendit si dhe kuptimin e rëndësisë së sigurimeve nga mjedisi ku në të shumtën e rasteve në praktikë e hasim termin kultura e sigurimeve. Sa më e madhe është kultura e sigurimeve edhe sigurimet si një shtyllë shumë e rëndësishme për ekonominë dhe vendin në tërësi të zhvilluar. Ekzistojnë limite të cilat ndalojnë përfitimet e sigurimeve. Sigurimi është formë e transferimit të rrezikut nga humbja, nga një entitet në tjetrin, në këmbim të pagesës (primit). Është formë e menaxhimit të rrezikut që përdoret për t'u mbrojtur nga rreziqet potenciale të cilat shkaktojnë humbje për të siguruarin.⁴

1.1 Funksionimi i biznesit të sigurimeve në Kosovë

Veprimtaria e biznesit të sigurimeve në Republikën e Kosovës është e rregulluar me dispozita juridike. Nuk është e lejuar asnjë kontratë e sigurimeve, respektivisht policë e sigurimeve e cila është në kundërshtim me Ligjin dhe aktet juridike nënligjore.

Ligji me të cilën rregullohen në përgjithësi sigurimet janë:

- * Ligji mbi Bankën Qendrore
- * Ligji mbi sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia
- * Ligji i marrëdhënieve detyrimore

Me këto dispozita juridike, kompetent për mbikëqyrjen dhe licencimin e kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve,

³ Dr. Safet Merovci, *Tregjet financiare*, Prishtinë 2008, f. 268.

⁴ C. Kulp & J. Hall, *Causaly insurance*, Fourth Edition, 1968.

është e autorizuar Banka Qendrore e Kosovës, e cila përveç mbikëqyrjes ka obligim edhe licencimin e kompanive të sigurimit si dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.⁵

1.2 Ligji mbi sigurimet

Në Kosovë ekziston Ligji mbi Sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, i miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës me datë 14.07.2011, pastaj Rregullorja e UNMIK 2001/25 dhe rregulloret e sigurimeve të Bankës Qendrore të Kosovës. Personat të cilët merren me shitjen e sigurimeve në Kosovë, që ndryshe njihen si agjent apo/dhe ndërmjetësues të sigurimeve, janë persona të kualifikuar, pasi ata paraprakisht trajnohen, dhe pasi t'i plotësojnë disa kritere të kërkuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ata marrin licence valide për të ushtruar një aktivitet të tillë.

1.3 Ligji për Sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia

Në vazhdimësi të aplikimit të dispozitave juridike nga lëmia e sigurimeve, Kuvendi i Kosovës me qëllim të ngritjes së nivelit dhe zhvillimit nga lëmia e veprimtarisë së sigurimeve, ka miratuar me datë 23 qershor të vitit 2011 Ligjin Nr. 04/L-018 për Sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, në përpilimin e të cilit kanë qenë të involvuar shumë ekspertë nga kjo lëmi. Ligji për Sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia përmban detajisht dhe në mënyrë më konkrete të dhëna mbi produktin e sigurimit të detyrueshëm, e rregulluar edhe nga dispozitat e mëhershme juridike siç është Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 si dhe rregullat e tjera të aprovuara nga Banka Qendrore e Kosovës - BQK. Pra në këtë Ligj përcaktohen obligimet e pronarëve, respektivisht të shfrytëzuesve të mjeteve motorike që para përdorimit të tij të kontraktjnë sigurimin për mbulimin e përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara palëve të treta, pa marrë parasysh se dëmi i shkaktuar është i natyrës materiale apo jomateriale.

Polica e sigurimit të detyrueshëm e cila njëherit është edhe kontratë mbi sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, e vlefshme për territorin e Republikës së Kosovës, duhet të kontraktohet në mes të të siguruarit dhe siguruesit të licencuar nga BQK, duke paguar preminë

⁵ Buletini i Sigurimeve në Kosovë - Nr. 2 Nëntor 2012, faqe 10.

e caktuar. Duke u bazuar në rregullimin e mëhershëm të kësaj lëmie, në këtë Ligj ka disa risi që kanë të bëjnë me përjashtimet nga mbulesa siguruese si dhe humbjen e mbulesës siguruese, që më herët nuk kanë qenë kaq të detajzuara.

2. Elementet e sigurimit

Elementet e sigurimit janë koncepti i rrezikut në sigurime, primi i sigurimit dhe dëmet e sigurimit.

Rreziku i sigurimit - *Rreziku* është një term shumë i përdorur nga kompanitë e sigurimit. Ai nënkupton mundësinë probabilitare të paraqitjes së një ngjarje të pakëndshme dhe padëshirueshme. Rreziku është mundësia që të dëmtohet, shkatërrohet, vidhen apo diçka e vlefshme cila është në pronësi të personit. Rreziku mund ta ketë kuptimin edhe të lëndimit të personit. Vlerësimi i rrezikut përfshinë përlllogaritjen e probabilitetit të paraqitjes së ngjarjes së siguruar dhe përlllogaritjen e efektit financiar i cili duhet mbuluar nga kompania e sigurimit.

Primi i sigurimit - Është një shumë e parave që një person i paguan kompanisë së sigurimit për blerjen e policës së sigurimit. Kjo pagesë mund të trajtohet si transferim i një pjese apo tërë rrezikut të humbjes apo dështimit. P.sh., riparimi, zëvendësimi apo rindërtimi i një pasurie të vlefshme në rast të vjedhjes, dëmtimit apo shkatërrimit. Kostot e primit të sigurimit duhet të merr në konsideratë numrin e pritshëm të kërkesave për kompensim apo dëmeve të shumëzuar me lartësinë mesatare të pritur të kompensimit. Askush nuk e di sigurt, nëse ose kur mund të dëmtohet, vidhet ose shkatërrohen diçka e vlefshme për të siguruarin ose kur mund të lëndohet dikush në rrugë ose në vendin e punës. Prandaj sigurimi bazohet në atë se çka mund të ndodhë ose mund të mos ndodhë në të ardhmen.

Dëmet - Një kërkesë për kompensim paraqitet atëherë kur personi kontakton kompaninë e sigurimit dhe kërkon që t'i kompensohet dëmi si rezultat i vjedhjes, dëmtimit, apo shkatërrimit të pasurisë së siguruar. P.sh., nëse një person e dëmton veturën e tij në një aksident dhe ai posedon policën e sigurimi e cila mbulon dëmin e shkaktuar nga ai aksident, atëherë ai kontraktin kompaninë e sigurimit për të kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti. Një kërkesë për kompensim mund të bëhet vetëm nëse primi është paguar dhe policja e

sigurimit e mbulon dëmin e shkaktuar. Kjo nënkupton që personi duhet të kontribuojë në sigurim para se të bëjë kërkesën për kompensim.⁶

Shoqata e Kompanive të Sigurimit të Kosovës, produktet kryesore të sigurimit të cilat i ofrojnë kompanitë e sigurimit në Kosovë:

- sigurimi i shëndetit familjar dhe grupor
- sigurimi i pasurisë nga zjarri
- sigurimi i shëndetit në udhëtim
- sigurimi i aksidenteve personale
- sigurimi i autopërgjegjësisë
- sigurimi i përgjegjësisë profesionale
- sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim
- sigurimi Kasko i automjeteve
- sigurimi i përgjegjësisë publike dhe produktit⁷

3. Ndarja e sigurimeve

Sigurimet kryesore ndahen në dy grupe: sigurimi i jetës dhe sigurimi i përgjithshëm

Sigurimi i jetës mbulon rrezikun e jetës së personit të siguruar. Në rast të vdekjes përfituesi do të pranojë shumën sipas policës së sigurimit. Sigurimi i jetës është kombinim i kursimit dhe sigurimit. Ky sigurim paraqet kursimin afatgjatë destinues, ndaj edhe për këtë arsye dallohet nga llojet tjera të sigurimit. Sigurimi i jetës fillimisht ka qenë i strukturuar për të mbrojtur të ardhurat familjeve, kryesisht atyre të reja, gjatë fazës së akumulimit të të ardhurave, në rast të vdekjes eventuale të zotit të shtëpisë. Në kohërat moderne, sigurimi i jetës përdoret për shumë arsye, përfshirë këtu, ruajtjen e pasurisë dhe planifikimin tatimor. Mandej dallimi shihet edhe në atë se te sigurimi i jetës, në çdo rast vihet në obligimin e siguresit për të bërë pagesën e shumës së siguruar dhe atë pas skadimit të afatit të kontraktuar të kohëzgjatjes së sigurimit ose pas vdekjes të personit të siguruar, nëse vdekja paraqitet gjatë kohëzgjatjes së sigurimit. Sigurimi i jetës ofron mbrojtjen dhe krijon sigurinë financiare të individit, të familjes së tij ose afarizmit të tij ndërkaq mbulohen këto rreziqe: vdekje e mbajtësit të familjes, shkollimi i fëmijëve, borxhet hipotekare, mbrojtja e afarizmit, mbrojtja e partneritetit. Sigurimet e jetës vazhdojnë të shënojnë rritje solide,

⁶ Arben Dermaku - Arbër Hoti, “*Kontabiliteti i institucioneve financiare*”, Prishtinë, 2013, f. 188, 184.

⁷ Po aty, (vep. cit.), Prishtinë, 2013, f. 188.

duke treguar se ky sektor i tregut të sigurimeve mbetet mjaftë atraktiv për investitorët dhe zgjerim të produkteve nga kompanitë ekzistuese. Tregu i sigurimeve në Kosovë, mbetet treg i sigurve dhe stabil, sa i përket kërkesave të stabilitetit financiar.

4. Analiza e sigurimeve të jetës dhe sigurimeve jo-jetë në periudhën 2011-2015

Sistemi i kompanive të sigurimit vazhdoi të zgjerojë aktivitetin edhe gjatë vitit 2011. Ndryshe nga viti i kaluar kur në industrinë e sigurimeve operonin gjithsej 11 kompani të sigurimit, gjatë vitit 2011 pjesë e kësaj industrie u bënë edhe dy kompani të reja, të cilat ofrojnë polica të sigurimit të jetës. Rrjedhimisht, numri i kompanive të sigurimit që ofrojnë sigurim jetësor në Kosovë arriti në tri kompani. Bashkë me 10 kompani tjera të sigurimit, të cilat ofrojnë polica për sigurimin jo-jetësor, në vitin 2011 në Kosovë operuan gjithsej 13 kompani të sigurimit. Sa i përket strukturës së pronësisë, nëntë kompani të sigurimit janë me pronësi të huaj, ndërsa katër kompani tjera janë me pronësi vendore. Struktura e pronësisë së aseteve të kompanive të sigurimit mbetet e ngjashme me vitet e kaluara. Gjithsej asetet e sistemit të kompanive të sigurimit në fund të vitit 2011 arritën vlerën prej **106 milionë euro** dhe shënuan rritje vjetore prej 9.4 për qind që paraqet trend të ngjashëm të rritjes me vitin e kaluar. Raporti ndërmjet kapitalit dhe gjithsej aseteve, i cili shprehë nivelin e kapitalizimit të kompanive të sigurimit, në vitin 2011 arriti në 41.2 për qind, krahasuar me 41.8 për qind në vitin 2010.⁸

Vlera e aseteve të kompanive të sigurimit arriti në **130.8 milionë euro** në vitin **2012**, një rritje prej 16.3 për qind. Industria e sigurimeve paraqet një nga sistemet e sektorit financiar gjatë vitit 2012 u karakterizua me një zgjerim. Tregu i kompanive të sigurimit vazhdimisht është karakterizuar me një shkallë të ulët të koncentrimit në treg, në krahasim me bankat.⁹

Struktura e sektorit të sigurimeve, gjatë vitit **2013** mbeti e ngjashme me vitet paraprake. Sektori i sigurimeve vazhdon të dominohet nga segmenti jo-jetë i cili përfaqëson 90 për qind të gjithsej sektorit, ndërsa pjesa e mbetur prej 10 për qind paraqet segmentin e sigurimit të jetës. Sipas pronësisë, struktura e sektorit vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 64.5 për qind të gjithsej aseteve të sektorit, por vërehet një rënie e pronësisë së huaj në

⁸ Raporti vjetor i vitit 2011.

⁹ Raporti vjetor i vitit 2012.

krahasim me vitin paraprak. Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve është dukshëm më e ulët në krahasim me sektorët tjerë financiar në Kosovë. Në dhjetor 2013, pjesëmarrja e aseteve të tri kompanive më të mëdha në vend ishte 35.6 për qind e gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve (38.12 për qind në vitin 2012). Vlera e aseteve të sektorit të sigurimeve, i cili përfaqëson 3.1 për qind të gjithsej aseteve të sistemit financiar të Kosovës, në vitin 2013 arriti në **132.5 milionë euro**, duke shënuar rritje vjetore prej 1.3 (16.3 për qind në vitin 2012). Në ngadalësimin e normës vjetore të rritjes kontribuoi rënia e theksuar e parapagimeve, aseteve teknike dhe aseteve të risigurimit. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 58 për qind të gjithsej aseteve. Pjesa tjetër përfaqësohet nga paraja e gatshme dhe asetet tjera.¹⁰

Struktura e sektorit të sigurimeve, gjatë vitit **2014** mbeti e ngjashme me vitet paraprake. Sektori i sigurimeve vazhdon të dominohet nga segmenti 'jo-jetë' i cili përfaqëson 89.9 për qind të gjithsej sektorit, ndërsa pjesa e mbetur prej 10.1 për qind paraqet segmentin e sigurimit 'jetë'. Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në vitin 2014 shënuan rritje vjetore prej 5.8 për qind, duke arritur vlerën **140.4 milionë euro**. Në kuadër të gjithsej aseteve, sigurimet jo-jetë përfshijnë 126.3 milionë euro, ndërsa sigurimet jetë 14.1 milionë euro. Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 82.0 milionë euro, që krahasuar me vitin 2013 paraqet një rritje prej 3.7 për qind. Primet e sigurimit jo-jetë kanë gjeneruar 79.6 milionë euro, ndërsa ato të sigurimit jetë 2.4 milionë euro. Vlera totale e dëmeve të paguara në vitin 2014 arriti në 33.4 milionë euro, një rënie vjetore prej rreth 17 për qind, prej të cilave 19.1 milionë euro ishin dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësishë ndaj palës së tretë. Zvogëlimi i shumës së dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit rezultoi në rënien e raportit të dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në 39.5 për qind krahasuar me 49.1 për qind sa ishte në vitin 2013, gjë që tregon për përmirësim të performancës së sektorit krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2014, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 318.8 mijë euro, krahasuar me humbjet prej 754.6 mijë euro vitin e kaluar.¹¹

Asetet e sektorit të sigurimeve në vitin **2015** shënuan rritje vjetore gjithsej prej 9.1 për qind, duke arritur vlerën 152.7 milionë euro. Sigurimet jo-jetë përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit (90.0 për

¹⁰ Raporti vjetor i vitit 2013.

¹¹ Raporti vjetor i vitit 2014.

qind të gjithsej aseteve të sektorit), dhe shënuan rritje vjetore prej 9.2 për qind, për dallim nga viti paraprak kur kishin shënuar rritje vjetore prej 5.1 për qind. Rritja e aseteve të sigurimit jo-jetë kryesisht rezultoi nga fillimi i operimit të dy kompanive të reja në këtë sektor. Ndërsa, pjesa tjetër e sektorit të sigurimeve përfaqësohet nga sigurimet e jetës, të cilat përfaqësojnë 10.0 për qind të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve. Asetet e sigurimit të jetës në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.7 për qind.¹²

Paraqitja grafike e sigurimeve jetë dhe sigurime jo jetë




Figura 1 Sigurimet jetë dhe sigurimet jo-jetë 2013-2015

Paraqitja grafike e aseteve të sigurimeve 2011-2014 në Kosovë




Figura 2 Asetet e sigurimeve 2011-2014

¹² Raporti vjetor i vitit 2015.

Conclusion

Insurance is a very effective tool through which people can control their financial losses, whether they are physical or legal persons. So security today is not something taboo, but they are a need for a safer future. In Kosovo today there is a well-consolidated insurance market, which has sufficient capacity to provide the necessary insurance to protect the citizens of Kosovo and their businesses from different events whether they are natural or other disasters, and which could cause considerable financial damage.

Life insurance is in low percentage compared with non-life insurance in Kosovo.

The insurance makes a significant contribution to the growth and stability of economic well-being, through the distribution of individual risks and the provision of hedge funds from the risks and financial consequences. Insurance is an institution that compensates for damages created in a society, within its economy or in people, due to the action of natural storms and disaster cases.

Think about health, nurturing, business, for others,

Recensentë

Prof. Dr. Arben Dermaku

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Literatura

Prof.Dr.Arben Dermaku, Arber Hoti, Kontabiliteti i Institucioneve Financiare, Prishtinë 2013

Dr.Safet Merovci, Tregjet financiare, Prishtinë 2008

C.Kulp &J.Hall, Causaly insurance, Fourth Editioni, 1968

[http://www.bqkkos.org/repository/docs/2015/FINALI_SISTEMI%20FINANCIAR_Nentor 20, 2016](http://www.bqkkos.org/repository/docs/2015/FINALI_SISTEMI%20FINANCIAR_Nentor%202016)

Byroja Kosovare e Sigurimeve

Raporti vjetor i vitit 2011

Raporti vjetor i vitit 2012

Raporti vjetor i vitit 2013

Raporti vjetor i vitit 2014

Raporti vjetor i vitit 2015